VENDIM
Nr.871, datë 12.8.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS QENDËR FIER, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Fier të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Fier të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.702, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Fier, të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Fier për zbatimin e këtij vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Fier Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i pronës**
1-132, 1008-1016	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
133	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
134-145	Varreza publike	Në pronësi
146-168	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
169	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
275-283	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
284-288, 1000, 1001	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
289-306	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
316-929	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
935,948,950,951,959, 992-999	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
960-971	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e	Në pronësi

	ujësjellës-kanalizimeve.	